

Gjykata Komunale Prizren
P 616/10
15 dhjetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE PRIZREN

Gjyqtari i EULEX-it Witold Jakimko si Kryetar i Trupit Gjykses,

i ndihmuar nga:

Robina Struthers, Eriona Bitri Breeding dhe Natasa Malesevic, si proces-mbajtëse,

në lëndën penale kundër:

1. të pandehurit **Bedri Krasniqi**, emri i babait Rifat, emri i nënës Ajete, e gjinisë Rushiti, lindur më 22 dhjetor 1962 në fshatin Majac, Komuna e Podujevës, tani banues në Prishtinë, Rruga Dardania III/2 lamela A1 Nr. 22, shqiptar i Kosovës, i martuar, babai i dy fëmijëve, ka diplomuar Fakultetin e Drejtësisë, gjendja ekonomike e mesme, i padënuar më parë në Kosovë, për momentin ende në liri,
2. të pandehurit **Xhevat Danqa**, emri i babait Vehbi, emri i nënës Xhejlane, e gjinisë Munhaxheri, lindur më 26 gusht 1955 në Pejë, tani banues në Prishtinë, shqiptar i Kosovës, i ve, babai i tre fëmijëve, ka diplomuar Fakultetin e Drejtësisë, gjendja ekonomike e mesme,

të akuzuar

sipas Aktakuzës PP. nr. 2549-15/08, datë 4 qershor 2008, me të cilën i pandehuri Xhevat Danqa u akuzua për veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, sipas Nenit 339, paragrafi 2, dhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, sipas Nenit 348, paragrafi 2, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i pandehuri Bedri Krasniqi ishte akuzuar më parë për veprën penale Nxjerrjes së Vendimeve Gjyqësore të Paligjshme, sipas Nenit 346 Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës,

siç përshkruhet më poshtë:

I pandehuri Xhevat Danqa,



I/a

Më 6 shtator 2007, në zyrën nr. 4 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke vepruar si person zyrtar, Prokuror Publik në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë, gjatë seancës së konfirmimit të Aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP. nr. 855-2/07, shpërdoroi pozitën zyrtare dhe e tejkaloi autorizimin zyrtar me qëllimin për t'i shkaktuar dëm të dëmtuarve Elham, Avni, Beqir Gavazi dhe Mihane Dema, duke mohuar të drejtën e tyre për të ngritur akuza penale, në shkelje të dispozitave të Nenit 313 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, i nxitur nga i akuzuari i dytë, e ndryshoi Aktakuzën e lart-përmendur në mënyrë të tillë që ajo nuk i akuzonte më të akuzuarit Qamush Bekteshi dhe Isuf Bekteshi për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, sipas Nenit 154 paragrafi 1 pika 5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, për të cilën ai ishte akuzuar në Aktakuzën me shkrim të ushtruar në gjykatë më 19 korrik 2007.

Me këtë ai kreu veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, sipas Nenit 339 paragrafi 2, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës,

I/b

Në të njëjtën ditë, të njëjtën datë dhe në të njëjtën cilësi si person zyrtar, ai përdori një dokument zyrtar të falsifikuar si dokument zyrtar origjinal – Aktakuzën PP. nr. 855-2/07, në të cilën i akuzuari i tretë kishte shkruar më parë informacionin e rremë sikur ajo ishte dorëzuar në gjykatë më 19 korrik 2007 në orën 15:20, me numër reference 617, dhe ia paraqiti atë të akuzuarit të dytë, i cili e përfshiu atë si dokument origjinal në shkresat e lëndës të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KAQ. nr. 375/07.

Me këtë ai kreu veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, sipas Nenit 348 paragrafi 2, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, në bashkëlidhje reale me veprën penale të përcaktuar nga pika I/a e këtij aktvendimi,

II. - I pandehuri Bedri Krasniqi

Më 6 shtator 2007, në vendin dhe kohën e përshkruar nën I/a të këtij dispozitivi, duke vepruar si Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në seancën e konfirmimit të Aktakuzës PP. nr. 855-2/07, datë 19 korrik 2007, të cilën ai e kryesonte si gjyqtar i konfirmimit të aktakuzës, me qëllimin për t'u shkaktuar dëm të dëmtuarve Elham, Avni, Beqir Gavazi dhe Mihane Dema, duke u mohuar atyre të drejtën e paditësit subsidiar, nuk thirri të pandehurin Isuf Bekteshi dhe të dëmtuarit sipas dispozitave të Nenit 313 paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, duke nxjerrë vendime gjyqësore të paligjshme duke konfirmuar me Aktvendimin KA. nr. 357/07, datë 6 shtator 2007, Aktakuzën e re të paraqitur nga i Pandehuri i parë, sikur ishte dorëzuar në gjykatë më 19 korrik 2007, që nuk përfshinte të akuzuarit Qamush Bekteshi dhe Isuf Bekteshi, të akuzuar për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, sipas Nenit 154 paragrafi 1 pika 5 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe nuk i informoi të



dëmtuarit për të drejtën e tyre për të ngritur padi penale sipas Nenit 62 paragrafi 1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

Me këtë ai kreu veprën penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme, sipas Nenit 346 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor

më 13 dhe 15 dhjetor 2010, në prani të të pandehurit Xhevat Danqa, Mbrojtësit të tij, Ymer Osaj, të pandehurit Bedri Krasniqi, mbrojtësit të tij Fazli Balaj, dhe Prokurores Publike Komunale të Prizrenit, Arijana Shajkovci,

shqipton këtë:

AKTGJYKIM

1. Në bazë të Nenit 390 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këtej e tutje KPPK), të pandehurit Xhevat Danqa dhe Bedri Krasniqi **nuk shpallen fajtorë** për veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, sipas Nenit 339 paragrafi 2, lidhur me Nenin 23, të KPK-së. Se më 6 shtator 2007, në Gjykatën e Qarkut dhe atë të PPK-së në Prishtinë, në bashkëkryerje, duke vepruar në cilësinë e personave zyrtarë, i pari në cilësinë e prokurorit të qarkut në Prishtinë dhe i dyti në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, shpërdoruan pozitën zyrtare dhe tejkaluan autorizimet zyrtare me qëllimin për t'u shkaktuar dëm të dëmtuarve Elham, Avni, Beqir Gavazi dhe Mihane Dema, duke u mohuar atyre të drejtën për të ngritur padi penale si paditës subsidiarë, në mënyrë të tillë që në zyrën nr. 4 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në seancën e konfirmimit të kryesuar nga Gjyqtari Bedri Krasniqi, para fillimit të seancës i akuzuari Bedri propozoi të ndryshohet Aktakuza PP. nr. 855-2/07 që ishte dorëzuar në gjykatë më 19 korrik 2007, ku akuzoheshin Ismail Bekteshi, Qamush Bekteshi dhe Isuf Bekteshi, dhe, pas marrëveshjes së arritur ndërmjet tyre, i akuzuari Xhevat e merr Aktakuzën dorazi, shkon në zyrat e PPQ-së në Prishtinë, të cilit më vonë i bashkëngjitet edhe i akuzuari Bedri, kështu që ata përpilojnë një Aktakuzë tjetër në të cilën të akuzuarit Qamush dhe Isuf Bekteshi nuk akuzohen më për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, sipas Nenit 154 paragrafi 1 pika 5 të KPPK-së, të cilën Aktakuzë i akuzuari Xhevat e nënshkruan dhe nëpërmjet një sekretari ligjor e proceson në gjykatë, e cila më vonë konfirmohet nga i akuzuari Bedri Krasniqi,

Kështu, në bashkëkryerje, pretendohet se ata kanë kryer veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, sipas Nenit 339 paragrafi 2 lidhur me Nenin 23 të KPK-së;

2. I pandehuri **Xhevat Danqa shpallet fajtor** sepse në të njëjtën ditë dhe orë, në zyrat e PPQ-së në Prishtinë, në cilësinë e personit zyrtar të akuzës para PPQ-së në Prishtinë, pas përpilimit përdor si dokument origjinal Aktakuzën e re PP. nr. 855-2/07, të cilën e nënshkruan dhe e vulos me vulë zyrtare dhe e dorëzon në gjykatë, në mënyrë të tillë që nëpërmjet të akuzuarit të tretë Agim Hasani, i cili në Aktakuzë shënon informacionin e rremë sikur ajo ishte dorëzuar në gjykatë më 19 korrik 2007, kjo Aktakuzë dorëzohet në



zyrën e të akuzuarit të dytë Bedri Krasniqi, i cili e përfshin këtë Aktakuzë si origjinale në shkresat e lëndës të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me KAQ Nr. 375/07, e cila më pas konfirmohet,

në këtë mënyrë, ai kreu veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare sipas Nenit 348 paragrafi 2 të KPPK-së, prandaj, në bazë të Nenit 348 paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me Nenet 3, 34, 42, 43, 44, 64 të Kodit Penal të Kosovës, kjo Gjykatë shqipton **dënim me kusht**, duke caktuar burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, ekzekutimi i të cilit nuk do të zbatohet nëse i pandehuri nuk kryen vepror tjetër penale gjatë një periudhe 1 (një) vjeçare nga data kur aktgjykimi merr formë të prerë;

3. Në bazë të Nenit 103 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 99 paragrafi 2 nën-paragrafët 1 deri në 5 të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit Bedri Krasniqi dhe shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit, do të paguhen nga burimet e buxhetit;

4. Në bazë të Nenit 102 paragrafi 4 të KPPK-së, kjo gjykatë e liron të pandehurin Xhevat Danqa nga detyrimi për të paguar në tërësi shpenzimet e procedurës penale, siç parashikohet në Nenin 99 paragrafi 2 nën-paragrafët 1 deri në 6 të këtij Kodi;

5. Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 të KPPK-së, kjo gjykatë përfshin kohën e kaluar në burgim në bazë të dënimit të mëparshëm të gjykatës së shkallës së parë, i cili u anulua me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl-Kzz 103/09, datë 22 prill 2010;

6. Në bazë të Nenit 391 paragrafi 1 nën-paragrafi 6 të KPPK-së, gjykata vendos se qëllimi i dënimit të caktuar ndaj Xhevat Danqës, nuk kërkon që aktgjykimi i formës së prerë të shpallet në shtyp, radio apo televizion.

ARSYETIM

I. Përbërja e trupit gjykues

1. Sipas Nenit 459 §1 dhe § 4 të KPPK-së, gjatë rishqyrtimit gjykata në marrjen e vendimit të ri është e detyruar t'i përmbahet Nenit 417 të KPPK-së. Me fjalë të tjera, gjykata duhet t'i kthehet Aktakuzës, por në atë pjesë në të cilën lënda nuk ishte finalizuar ligjërisht më parë në mënyrë absolute. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën në të cilën nuk u ankimua nga Prokuroria Komunale, u bë i formës së prerë. Ankesa e PK-së u ushtrua vetëm në lidhje me dënimin. Kjo do të thotë që kualifikimi i një vepre si nxjerrja e vendimit të paligjshëm u hoq efektivisht, në kuptimin ligjor të saj, nga përshkrimi i veprës së përcaktuar në Aktakuzë. Prokurorja Publike nuk paraqiti kundërshtim në lidhje me këtë çështje. Ky qëndrim u shpreh qartë prej saj në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13 dhjetor 2010.

2. Për shkak të rrethanave të mësipërme dhe sipas parimit të ndalimit të *reformationis in peius*, gjykata tani trajtoi veprat e shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar dhe të



falsifikimit të dokumenteve zyrtare, dhe jo më veprën e nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme (Neni 346 i PKPK-së). Këto vepra janë të dënueshme vetëm me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe kështu ato gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Sipas Nenit 22 § 3 të KPPK-së, veprat penale të dënueshme me gjobë ose burgim deri në tre vjet gjykohen nga një gjyqtar i vetëm i Gjykatës Komunale.

3. Mbrojtësi i Xhevat Danqës, avokati Ymer Osaj, propozoi në fillim të shqyrtimit kryesor që ky shqyrtim të mbahet në mungesë të të pandehurit Xhevat Danqa, i cili ishte thirrur me rregull, sipas Nenit 472 paragrafi 1 të KPPK-së. Në bazë të Nenit 572 §1 të KPPK-së, Kryetari i Trupit Gjykses vendosi ta zhvillonte shqyrtimin në mungesë të të pandehurit Xhevat Danqa, duke marrë parasysh dispozitat për procedurën e shkurtuar.

II. Ecuria e procedurës

1. Në datën 04 qershor 2008 u ushtrua Aktakuzë kundër të pandehurve Bedri Krasniqi, Xhevat Danqa dhe Agim Hasani (PP. Nr. 2549/08), e cila, sipas Aktvendimit KA. Nr. 168/08, u konfirmua nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 26 qershor 2008.

2. Më 16 janar 2009, Gjykata Komunale e Prizrenit, nën numrin e regjistrimit P. Nr. 874/08, shqiptoi Aktgjykimin, në të cilin Bedri Krasniqi u gjet fajtor për veprën penale të shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, në bashkëkryerje me të akuzuarin Xhevat Danqa, në shkelje të Nenit 339 paragrafi 2 lidhur me Nenin 23, të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe kështu u dënua me 5 (pesë) muaj burgim.

3. I pandehuri Xhevat Danqa, i cili në kontekstin përkatës vepronte në cilësinë e tij si Prokuror i Qarkut, u gjet fajtor edhe për përdorimin e një Aktakuze të re me numër regjistrimi PP. Nr. 855-2/07, si të vërtetë dhe të vulosur, duke ia dërguar atë të pandehurit Bedri Krasniqi në cilësinë e tij si Gjyqtar i Konfirmimit të Aktakuzës. Të pandehurit iu caktua dënimi unik prej 6 (gjashtë) muajsh burgim, i cili përbëhej nga 5 (pesë) muaj për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare, në shkelje të Nenit 339 paragrafi 2 të KPK-së, të kryer në bashkëpunim me të pandehurin Bedri Krasniqi, dhe 3 (tre) muaj “për veprën penale sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi”.

4. Më 24 shkurt 2009, Mbrojtësi i mëparshëm i të pandehurit Xhevat Danqa ushtroi ankesë brenda afatit kundër Aktgjykimit të shkallës së parë dhe propozoi që i pandehuri të shpallej i pafajshëm ose të anulohej Aktgjykimi në fjalë dhe lënda t’i kthehej Gjykatës Komunale për rishqyrtim. Një ankesë tjetër u ushtrua nga Mbrojtësi tjetër më 04 mars 2009, duke kërkuar gjithashtu që i pandehuri të shpallej i pafajshëm ose të anulohej Aktgjykimi në fjalë dhe lënda të kthehej për rishqyrtim.

5. Aktgjykimi i shkallës së parë u ankimua brenda afatit nga Mbrojtësi i të akuzuarit Bedri Krasniqi. Ndërsa në datën 02 mars 2009, Mbrojtësi ushtroi ankesë duke propozuar që i pandehuri Bedri Krasniqi të shpallej i pafajshëm ose të anulohej Aktgjykimi i shkallës së parë dhe lënda t’i kthehej Gjykatës Komunale për rishqyrtim.



6. Edhe Prokuroria Komunale ushtroi ankesë brenda afatit, më 20 mars 2009, dhe kërkoi dënim më të rëndë për të tre të pandehurit.

7. Më 02 korrik 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren si Gjykatë e shkallës së dytë shpalli Aktgjykimin e saj AP. Nr. 35/2009, duke hedhur poshtë ankesat e ushtruara nga Mbrojtësit e të tre të pandehurve dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin e shkallës së parë.

8. Më 31 gusht 2009, Mbrojtësi i të pandehurit Bedri Krasniqi bëri Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që i akuzuari Bedri Krasniqi të shpallej i pafajshëm, ose të anulohet në tërësi Aktgjykimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë dhe lënda të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

9. Më 12 prill 2010, Prokuroria e Shtetit e Kosovës (PSHK) paraqiti mendimin e saj duke propozuar që kërkesa e të pandehurit Bedri Krasniqi të pranohet pjesërisht në drejtim të anulimit të kërkuar të Aktgjykimin të shkallës së parë dhe të urdhërohet rishqyrtimi i lëndës dhe që vendimi i Gjykatës Supreme të përfshijë, sipas Nenit 454 paragrafi 2 të KPPK-së, të pandehurin Xhevat Danqa.


10. Më 25 mars 2010, Mbrojtësi i të pandehurit Bedri Krasniqi i paraqiti kërkesë Presidentes së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (PGJE) dhe kërkoi që lënda të gjykohej nga Gjyqtarët e EULEX-it, e cila u pranua. Asnjëri prej të Pandehurve të tjerë dhe/ose Mbrojtësit e tyre nuk e propozuan këtë, por me kërkesë të Gjykatës Supreme, Mbrojtësi i të pandehurit Agim Hasani shpjegoi me telefon se vetëm kishte bërë kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme dhe për të nuk kishte rëndësi nëse lënda gjykohej nga gjyqtarët e EULEX-it apo ata kosovarë. Ai nënvizoi vetëm interesin që të merrej një vendim i shpejtë dhe i drejtë.

11. Më 22.4.2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pkl-Kzz 103/09, shqiptoi këtë aktgjykim në lidhje me dy të pandehurit në këtë lëndë:

- Aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë, datë 16 janar 2009, P. Nr. 874/08, dhe të gjykatës së shkallës së dytë, datë 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009, kundër të pandehurit Bedri Krasniqi anulohen dhe lënda i kthehet Gjykatës Komunale të Prizrenit për rishqyrtim.

- Vendimi për anulimin e Aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë dhe kthimi i lëndës në Gjykatën Komunale të Prizrenit për rishqyrtim përfshiu edhe të bashkë-akuzuarin Xhevat Danqa, sipas Nenit 455 paragrafi 2 të KPPK-së.

- Ekzekutimi i vendimit përfundimtar të Gjykatës Komunale në Prizren, datë 16 janar 2009, P. Nr. 874/08, u la kështu në fuqi nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren datë 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009, kundër të pandehurve Bedri Krasniqi dhe Xhevat Danqa, u ndërpre në përputhje me Nenin 454 paragrafi 4 të KPPK-së.



12. Më 13 dhjetor 2011, gjykata e shkallës së parë nisi shqyrtimin kryesor. Në bazë të Nenit 572 paragrafi 1 të KPPK-së, Kryetari i Trupit Gjykes vendosi ta zhvillojë shqyrtimin në mungesë të të pandehurit Xhevat Danqa.

13. Procedura në këtë lëndë filloi me një seancë paraprake të mbajtur më 30 nëntor 2010 dhe u vijua me shqyrtimin kryesor më 13 dhe 15 dhjetor 2010.

III. Provat e administruara

1. Gjatë seancave të shqyrtimit, dëshmitarët Qamush Bekteshi dhe Isuf Bekteshi dëshmuan më 13 dhjetor 2010. I pandehuri Bedri Krasniqi u dëgjua më 13 dhjetor 2010 dhe i pandehuri Xhevat Danqa më 15 dhjetor 2010.

2. Gjykata pranoi si prova këto dokumente dhe deklaratat e këtyre dëshmitarëve, që u lexuan gjatë shqyrtimit kryesor, sipas Nenit 368 paragrafi 3 të KPPK-së:

- i) Prova A1: Aktakuza kundër Ismail, Qamush dhe Isuf Bekteshit (PP. Nr. 855-2/2007, 19.7.2007)
- ii) Prova A2: Aktakuza kundër Ismail Bekteshit (PP. Nr. 855-2/2007, 19.7.2007)
- iii) Prova A3: Padia subsidiare e palës së dëmtuar
- iv) Prova A4: Aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut Prishtinë për konfirmimin e Aktakuzës (KA Nr. 375/07, 6.9.2007)
- v) Prova A5: Aktvendimi i të njëjtit gjyqtari për konfirmimin e padisë subsidiare (KA Nr. 375/07, 26.12.2007)
- vi) Prova A6: Kopje të vulave të pranimit të Aktakuzave të cekura më lart nga Gjykata e Qarkut Prishtinë
- vii) Prova A7: KAQ e shkrimtores së Gjykatës së Qarkut Prishtinë
- viii) Prova A8: Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë (P. Nr. 409/7) kundër Ismail, Qamush dhe Isuf Bekteshit
- ix) Prova A9: Dokumentet mjekësore të Xhevat Danqës
- x) Deklarata e dëshmitares Qamirane Troshupa
- xi) Deklarata e dëshmitares Burbuqe Korqa
- xii) Deklarata e dëshmitarit Asllan Ademi
- xiii) Deklarata e dëshmitares Shukrije Krasniqi
- xiv) Deklarata e dëshmitarit Xhafer Zharku
- xv) Deklarata e dëshmitares Elhame Blaku
- xvi) Deklarata e dëshmitarit Avni Ibrahim
- xvii) Deklarata e dëshmitares Sadije Mjekiqi
- xviii) Deklarata e dëshmitarit Beqir Gavazi
- xix) Deklarata e dëshmitarit Elham Gavazi
- xx) Deklarata e dëshmitares Mihane Dema

4. Provat që ndikojnë në gjetjet e Gjykatës janë shtjelluar qartësisht në paragrafët vijues. Provat e tjera nuk kishin ndikim të drejtpërdrejtë në përmbajtjen përfundimtare të dispozitivit.


IV. Gjetjet faktike dhe ligjore

1. Asnjëri prej dëshmitarëve nuk ka vënë re ndonjëherë ndonjë parregullsi ose sjellje të mundshme të gabuar të kryer nga i pandehuri Bedri Krasniqi si gjyqtar gjatë gjykimit të lëndëve penale.

2. Pala e dëmtuar, Elham Gavazi, lidhur me veprën nga Neni 339 të KPK-së deklaroi se ajo dyshonte se mund të kishte pasur korrupsion në lidhje me Xhevat Danqën, sepse ai kishte këmbëngulur gjithnjë në lirimin e të pandehurve pa ndonjë akuzë, duke hequr emrat e tyre nga Aktakuza. Ajo deklaroi se besonte se ai kishte marrë para nga njerëzit që kishin vrarë vëllain e saj dhe kishin plagosur atë vetë. Në të njëjtën kohë, kur u pyet nga Gjyqtari, ajo u përgjigj se nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë provë të kësaj teze. Kjo deklaratë nuk u përfshi në tërësinë e provave dhe ajo përfaqësonte vetëm mendimin personal që nuk ishte i bazuar në ndonjë provë materiale.

3. Qëllimi i parashikuar nga ligji, që mendohet të kenë pasur të pandehurit, ishte të ndërmerrnin veprim për sigurimin e një përfitimi pasuror të paligjshëm ose të shkaktonin dëm. Të pandehurit nuk siguruan ndonjë përfitim pasuror, ata nuk shkaktuan ndonjë dëm pasuror, dhe veprimet e tyre nuk synuan të siguronin ndonjë përfitim, as t'u shkaktonin qëllimisht dëme, përfshirë ato jo-pasurore, personave të tjerë. Akuza nuk paraqiti ndonjë provë të posaçme të drejtpërdrejtë (përfshirë dëshmitarët e dëgjuar) për këtë qëllim të posaçëm (siç u përshkrua më lart) të të pandehurve lidhur me veprën e shpërdorimit të pozitës ose autorizimit zyrtar, me të cilën u akuzuan të dy. Prandaj gjykata u detyrua të merrte parasysh vetëm provat që ishin në zotërim të saj. Deklaratat e dëshmitarëve, të cilat u lexuan, si dhe ato të dhëna gjatë seancave të shqyrtimit kryesor patën karakter plotësues të dokumenteve të përfshira në tërësinë e provave. Megjithatë gjykata përfshiu në tërësinë e provave si Provën A8 aktgjykimin shumë të rëndësishëm të Gjykatës së Qarkut Prishtinë (P. Nr. 409/7) kundër Ismail, Qamush dhe Isuf Bekteshit, çka provon se të gjithë këta të pandehur ishin dënuar me sukses me pjesëmarrjen e palëve të dëmtuara.

4. Dokumentet e përfshira në tërësinë e provave nuk dhanë ndonjë argument për t'i gjetur të pandehurit fajtorë për shpërdorimin e pozitës ose autorizimit zyrtar. Nuk ka dyshim se analizimi i gjendjes mendore të të pandehurve nuk u lejua të bazohej vetëm në dokumente. Në zotërim të gjykatës nuk u vu asnjë tjetër provë të paktën rrethanore, që të pasqyronte qëllimin konkret në mendjen e tyre kur morën vendimin që është në shqyrtim. Vlerësimi i mësipërm bëhet duke zbatuar të gjitha provat *en bloc*. Për mendimin e gjykatës, gjatë gjykimit ose gjatë hetimit gabime mund të ndodhin, kryesisht kur prokurorët kanë ngarkesë të madhe pune dhe punojnë nën trysni. Çdo gabim i bërë nga një gjyqtar ose prokuror gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, nuk mund të shpjerë patjetër në nisjen e hetimit penal sipas Nenit 339 të KPK-së. Ky keqinterpretim ose zbatim i gabuar i dispozitave ligjore mund të zgjidhet nga gjykata e shkallës së dytë gjatë procedurës së ankesës. Në rastin tonë, nuk u vërtetua se të dy të pandehurit vepruan me qëllimin për të siguruar një përfitim të paligjshëm pasuror për veten ose për ndonjë person tjetër, apo për t'i shkaktuar dëm ndonjë personi tjetër, siç kërkohet në Nenin 339 të KPK-së. Gjykata i shqyrtoi provat në dritën e Nenit 339 të KPK-së dhe deklaroi se më



poshtë dhe nuk ka gjetur ndonjë argument faktik në mbështetje të Aktakuzës në lidhje me veprën e shpërdorimit të pozitës zyrtare.

5. I pandehuri Bedri Krasniqi nuk e njihte palën e dëmtuar, as të pandehurit në lëndën në të cilën u ushtrua Aktakuza deri në nisjen e procedurës para Gjykatës Komunale në Prizren. Pala e dëmtuar u përfaqësua nga Sadije Mjekiqi dhe ajo u njoftua për seancën e konfirmimit dhe bashkë me thirrjet. Aktakuza u paraqit me rregull. Gjykata i dha besim të plotë kësaj deklaratë për shkak të mungesës së ndonjë prove në të kundërt.

6. Gjykata e vlerësoi deklaratën e të pandehurit Bedri Krasniqi si të besueshme. Ai ia shpjegoi procedurën Prokurorit Publik dhe në të njëjtën kohë e paralajmëroi atë se përshkrimi faktik i disa elementeve të veprës penale nuk ishte i saktë: lëndim i rëndë trupor sipas Nenit 155 nën-paragrafi 5, vendi i incidentit, as mjetet që u përdorën, as rrethanat në të cilat ndodhi incidenti. I pandehuri i sugjeroi Prokurorit të ndryshonte Aktakuzën. Sugjerimi nuk përfshiu informacionin se si ta bënte këtë. Qëllimi i ndryshimit ishte të shmangej çdo element mungues në Aktakuzë dhe me qëllim që ajo të përpilohej sipas ligjit. Ky ishte qëllimi i punës së Bedri Krasniqit. Bindja e bazuar e Gjykatës është se ky ishte qëllimi i vërtetë i veprimit të Bedri Krasniqit, prandaj dëshmia e tij u pranua plotësisht në këtë çështje. I pandehuri Bedri Krasniqi parashtroi mendimin se ai nuk ishte përfshirë asnjëherë në përpilimin e kësaj Aktakuze, as në mënyrë teknike, as në mënyrë materiale. Sipas asaj që tha Bedri Krasniqi, si gjyqtar ai ishte shumë herë i detyruar ta kthente një aktakuzë për ndryshime, kur ajo nuk ishte përpiluar në pajtim me ligjin. Si gjyqtarët, ashtu dhe prokurorët ishin të mbingarkuar me punë dhe kishin një numër të madh lëndësh për të punuar. Kështu ishte edhe me Prokurorin tjetër Publik të asaj zyre dhe sigurisht të tilla raste ishin edhe me të tjerët. Nuk ka arsye objektive për ta vënë këtë në dyshim.

7. Bedri Krasniqi pretendoi se nuk ishte shoqëruar asnjëherë me Xhevat Danqën dhe madje nuk kishte pirë asnjëherë kafe me të. Ky pretendim u vlerësua si plotësisht i besueshëm.

8. I pandehuri Xhevat Danqa u vetë-deklarua jo fajtor për veprën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, as të nxjerrjes së vendimeve të paligjshme. Xhevat Danqa deklaroi se e kishte trashëguar lëndën nga kolegja e tij, e cila kishte ndryshuar vendin e punës. Sipas informacionit nga përmbajtja e shkresave të lëndës, ai dorëzoi Aktakuzën. Më pas ai mori ftesë nga Gjyqtari i Konfirmimit. Xhevat Danqa bëri një konsultim me gjyqtarin. Xhevat Danqa deklaroi se ndryshimet që kishte bërë, nuk kishin për qëllim t'i shkaktonin dëm ndonjë personi, as të bënin të pamundur që ndonjë person të realizonte të drejtat e tij sipas ligjit. Në atë kohë atij i ishin caktuar më shumë se 700 lëndë. Ai kishte kryer 430 ndër 490 lëndë. Bazuar në natyrën e lëndëve, ata kishin të bënin me trafikimin në qenie njerëzore dhe drogë. Pasi Aktakuza e dytë ishte përpiluar, sekretarja e Xhevat Danqës depozitoi Aktakuzën.

9. Për mendimin e gjykatës, versioni i mësipërm është i besueshëm, përveç faktit se sipas dokumenteve të përfshira në tërësinë e provave, nuk ka dyshim për gjykatën se i pandehuri kishte kryer veprën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare. Praktikën e këqija të

vendosura në Prokurori, edhe nëse kjo metodë ishte shumë e zakonshme, nuk e ndryshojnë faktin se veprimi i të pandehurit përbën veprë penale. Duke krahasuar Provën A1 dhe Provën A2, gjykata vëren dallime të dukshme ndërmjet tyre në thelbin e tyre. Nga njëra anë, është e pamundur që një Aktakuzë me të njëjtën datë të jetë ligjërish e vlefshme në dy versione. Gjykata beson se nuk ka nevojë të jesh jurist për ta kuptuar një rrethanë të tillë. Për më tepër, prokurori nuk ka mundësi të ndryshojë përmbajtjen ligjore të Aktakuzës së mëparshme thjesht duke hequr një pjesë të saj (dy të Pandehur!) dhe duke e ushtruar atë me të njëjtën datë dhe numër reference drejtpërdrejt tek gjyqtari, madje pa e dorëzuar në shkrimtoren e gjykatës. Përveç shfajësimit që i pandehuri Xhevat Danqa ishte i mbingarkuar me punë, mbrojtja nuk i paraqiti gjykatës ndonjë skenar ose shpjegim tjetër të mundshëm të veprimit të të pandehurit në këtë çështje. Gjykata ndan pikëpamjen se edhe numri i lartë i këtij lloj veprimi nuk është shfajësim i mjaftueshëm që mund të kishte efekt shfajësues në lidhje me veprën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare me të cilën u akuzua i pandehuri. Për më tepër, duhet theksuar se vepra e falsifikimit të dokumenteve zyrtare është veprë formale dhe nuk kërkon ndonjë qëllim që posaçëm në veprimin e të pandehurit.

10. Provat e administruara e bëjnë gjykatën të arrijë në përfundimin se Xhevat Danqa, në cilësinë e personit zyrtar të akuzës para PPQ-së në Prishtinë, pas përpilimit përdori si origjinal dokumentin – Aktakuzën e re PP. nr. 855-2/07, të cilën e nënshkroi dhe i vuri vulën zyrtare dhe e dorëzoi atë në gjykatë, në mënyrë të tillë që nëpërmjet të akuzuarit të tretë, Agim Hasani, i cili në këtë Aktakuzë shënoi informacion të rremë sikur ai ishte dorëzuar në gjykatë më 19 korrik 2007, ky dokument u paraqit në zyrën e Bedri Krasniqit. Aktakuza me KAQ nr. 375/07 u konfirmua më vonë. Për mendimin e gjykatës, konstatimet e mësipërme përshkruajnë në mënyrë bindëse veprën e kryer nga i pandehuri.

11. Vepra e falsifikimit të dokumenteve zyrtare sipas Nenit 348 paragrafi 2 të KPK-së përbën përgjegjësinë e veçantë të një personi i cili është përgjegjës ose zyrtar dhe përdor një dokument të rremë zyrtar ose pune sikur ai të ishte i vërtetë, në detyrën ose punën e tij, ose që shkatërron, fsheh, dëmton ose përndryshe bën të papërdorshëm këtë dokument zyrtar ose pune. Xhevat Danqa nga ky këndvështrim ishte subjekti aktiv i kësaj vepre.

12. Lidhur me dënimin për veprën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare të caktuar ndaj të pandehurit Xhevat Danqa, duhet ngritur kjo çështje. Pikë së pari, ne duhet t'i përgjigjemi pyetjes për qëllimin që duhet arritur nëpërmjet dënimit. Qëllimi i dënimit është ndëshkimi në kuptimin e parimit të drejtësisë dhe përpjesëtueshmërisë dhe se ai duhet të arrijë objektivin e parandalimit të përgjithshëm. Parametrat e rëndësishëm në përlogaritjen e dënimit, përfshirë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas Nenit 64 dhe në vijim të Kodit Penal të Kosovës, analizohen më poshtë. Dënimi duhet të jetë përpjesëtimor me shkallën e përgjegjësisë penale të kryerësit dhe peshën e veprës së kryer.

13. *Shkalla e përgjegjësisë penale.* Intensiteti i veprimit nga ana e kryerësit nuk ishte në nivelin që kërkon një dënim më të rëndë se burgimi prej 3 (tre) muajsh. Shkalla e përgjegjësisë penale të Xhevat Danqës është mesatare, veçanërisht duke marrë parasysh numrin e lartë të rasteve të kësaj lloj praktike. Mbrojtësi solli në vëmendje të gjykatës se

në këtë rast kemi të bëjmë me dy aktakuza. Ai theksoi se lidhur me propozim-akuzën, PP. Nr. 2549-15/08, datë 04/06/2008, kundër Xhevat Danqës, Bedri Krasniqit dhe Agim Hasanit lidhur me të njëjtën lëndë me të njëjtin numër reference, ne kemi 2 aktakuza, njëra propozim-akuzë dhe tjetra është thjesht aktakuzë dhe të dyja janë të datës 4 qershor 2008. Ai e theksoi këtë në përshkrimin faktik të veprave, të cilat ishin identike me përshkrimin faktik të veprës që ka të njëjtin numër të prokurorisë kundër të njëjtteve të pandehur. Dokumentet e mësipërme janë pjesë e shkresave kryesore. Nuk është e nevojshme që këto t'i vendosim në tërësinë e provave si prova shtesë. Duhet thënë se lidhur me Aktakuzën e ngritur kundër Xhevat Danqës dhe Bedri Krasniqit nuk ka bazë ta trajtojmë atë si të rreme ose të lëshuar duke shpërdoruar autoritetin zyrtar. Në një farë shkalle kjo tregon mekanizmin e depozitimit të aktakuzave dhe standardet e qarkullimit të dokumenteve.

14. *Motivet për të cilat është kryer vepra.* Për mendimin e gjykatës, motivi i mundshëm për Xhevat Danqën ishte të kryente punë me lëndën dhe ta hiqte nga Prokuroria sa më shpejt të ishte e mundur. Në vend të procedurës që kërkon kohë në pajtim me ligjin, ai zgjodhi rrugën e shkurtër të paligjshme duke falsifikuar dokumentin e dorëzuar më parë. Dënimi ligjor duhet të jetë në pajtim me provat e mbledhura në këtë lëndë. Dënimi i caktuar në dispozitiv është përpjesëtimor dhe i saktë, duke marrë parasysh motivet e të pandehurit.

15. *Intensiteti i rrezikut penal ose dëmtimit të vlerës së mbrojtur.* Ndikimi negativ i kësaj vepre në funksionimin e duhur të gjyqësorit, që mund ta bëjë gjykatën të arrijë në përfundimin e shkallës së rrezikut të shkaktuar nga ky veprim, veçanërisht nga pikëpamja e vlerës së mbrojtur, është relativisht i lartë. Vlerësimi është i kuptueshëm dhe esencial për parimin e mbrojtjes së drejtësisë penale.

16. *Jeta e mëparshme e kryerësit.* Lidhur me këtë rrethanë, para kryerjes së veprës penale, i pandehuri nuk e kishte shkelur kurrë ligjin më parë. Ai ishte jurist me profesion. Këto dy argumente përcaktojnë rrethana të fuqishme lehtësuese që duhet të merren parasysh në llogaritjen e dënimit.

17. *Statusi personal i kryerësit.* Gjykata mori parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri është shumë i sëmurë. Ai i paraqiti gjykatës një raport mjekësor. Gjykata ka vendosur kontakt të drejtpërdrejtë me të pandehurin. Gjendja shëndetësore e të pandehurit ishte shumë e rëndë dhe ai mezi qëndronte në këmbë dhe ecte me vështirësi. Ai e dha deklaratën i ulur.

18. *Qëndrimi i kryerësit pas kryerjes së veprës penale.* Sjellja e kryerësit si i akuzuar gjatë gjithë procedurës penale ka qenë e rregullt, ai ka qenë bashkëpunues. I pandehuri Xhevat Danqa nuk ka mohuar asnjë element faktik në këtë lëndë. Ai nuk u vetë-deklarua faktor sepse e vlerësonte ndryshe rolin e tij në këtë vepër.

19. Dënimi me burgim, i llogaritur sipas përmbajtjes së Nenit 64 të KPK-së, kushteve të cekura më lart dhe sipas qëllimeve të përmendura në Nenin 34 të KPK-së, veçanërisht në parandalimin e kryerësit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e

kryerësit, është përcaktuar për një periudhë tre mujore si dënimi më i përpiktë, përpjesëtimor dhe i saktë.

20. Për mendimin e gjykatës, Xhevat Danqa meriton zbatimin e dënimit me kusht për të. Dënimi me kusht i jep të pandehurit një qortim dhe e arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit (shkëputur nga Neni 42 i KPK-së). Jeta e mëparshme e kryerësit provon se ai nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale (shkëputur nga Neni 43§2 i KPK-së). Gjykata përcaktoi periudhën e verifikimit prej 1 viti, e cila është e kënaqshme. Edhe kushtet e tjera të parashikuara nga Neni 44 i KPK-së janë përmbushur. Vepra penale e parashikuar në Nenin 348 paragrafi 2 të KPK-së është e dënueshme deri në 3 vjet. Sjella e kryerësit në të shkuarën, sjellja e tij pas veprës dhe shkalla e përgjegjësisë penale nuk e kundërshtojnë caktimin e dënimit me kusht ndaj të pandehurit Danqa. Të gjitha këto kushte janë analizuar më parë nga gjykata. Objektivi i parandalimit të përgjithshëm mund të arrihet me anë të funksionit moral-etik të ligjit penal. Për rrjedhojë, dënimi me kusht, për shkak se në të është përfshirë vlerësimi social-etik i veprës së kryer, mund të kontribuojë në arritjen e objektivave të cekura më lart. Gjykata percepton se mundësia e këtyre objektivave mund të arrihet nëpërmjet dënimit me kusht në këtë lëndë.

21. I pandehuri Bedri Krasniqi u lirua nga akuza, prandaj të gjitha shpenzimet e nevojshme të tij, si dhe shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit do të paguhen nga buxheti sipas bazës ligjore të përcaktuar në dispozitivi.

22. Gjykata e liroi të pandehurin Xhevat Danqa nga detyrimi për të paguar të gjitha shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së tij të keqe financiare dhe gjendjes shëndetësore të tij.

23. Gjykata përfshiu kohën e kaluar në burgim në bazë të dënimit të mëparshëm të shkallës së parë, që u anulua nga me aktgjykim të Gjykatës Supreme, Pkl-Kzz 103/09, datë 22 prill 2010.

24. Gjykata vendosi se qëllimi i dënimit të caktuar ndaj Xhevat Danqës, nuk kërkon që aktgjykimi përfundimtar të shpallet në shtyp, radio apo televizion dhe nuk ka nxjerrë urdhër për këtë çështje.

MJET JURIDIK: Në bazë të Nenit 473(3) të KPPK-së, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të një kopjeje të këtij Aktgjykimi.

Witold Jakimko
Kryetar i Trupit Gjykses

Natasa Malesevic
Proces-mbajtëse

